



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.07.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i trotuareve në Komunën e Gjakovës”, me Nr. të Prok: 632-21-2265-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-042-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik Joos & Krasniqi-Bazë” sh.p.k e dt.12.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi i trotuareve në Komunën e Gjakovës”, me Nr. të Prok: 632-21-2265-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-042-521, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 09.07.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

3. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , e publikuar me datë: 09.07.2021;

5. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit ;

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit ""Sanimi i trotuareve në Komunën e Gjakovës", me Nr. të Prok: 632-21-2265-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-042-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Pretendimi juaj lidhur me Vërtetimin e Gjykatës, ATK-së dhe Tatimit në pronë të Operatorit ekonomik N.SH.T."Viktory Com" & "Company Murseli"sh.p.k., nuk qëndron sepse Operatori në fjalë këto vërtetime i ka ngarkuar në platformë dhe i ka sjell kopjet fizike, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

-Pretendimi juaj që ka të bëjë me deklaratën nën betim, është i pa bazuar sepse shtimi i emrit të aktivitetit dhe nr.prokurimit në Dekleratën nën betim nuk përbën shkelje por është vetëm devijim minor neni 59 pika 4 e LPP-së:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

- Pretendimi juaj lidhur me Vërtetimin e ATK-së të Operatorit ekonomik N.SH.T."Viktory Com", nuk qëndron sepse i njëjti me dt.30.06.2021 e ka ngarkuar në sistem dhe e ka sjellë kopjen fizike të Vërtetimin e ATK-së, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

-Pretendimi juaj lidhur me Vërtetimin e Tatimit në pronë të Operatorit ekonomik "Company Murseli"sh.p.k., nuk qëndron, sepse ky vërtetim nuk është e thënë të nxirret sa herë aplikon, mjafton të jetë origjinal ose i noterizuar dhe i vitit fiskal ekzistues, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

-Pretendim juaj se z.Beqë Hadergjonaj, i mungon kontrata e punës dhe CV-ja, nuk qëndron sepse në bazë të Nenit 72 të LPP-së, këto dokumente i janë kërkuar konzorciumit në fjalë, të cilat dokumente me dt.16.06.2021, i kanë ngarkuar në platformë, prandaj pretendimi juaj është i pabazuar.

-Pretendimi per referenca nuk qëndron sepse operatori në fjalë vetëm me tri referencat e mëposhtme i mbulon kërkesat e Autoritetit kontraktues:



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	05.05.2020
REFERENC-E	06/Zyrtarishp
PËR/ZA/TO:	N.R.K.T. "VICTORY Com", Gjakovë
CC:	
PËRMËS/PREKO/THROUGH:	Z. Beshe Rexha, Menaxher i projektit
NGA/OD/FROM:	Z. Ferdinand Kola, Drejtar për Zhvillim Ekonomik
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	REFERENCË

Me kërkesën e Operatorit Ekonomik N.S.H.T. "VICTORY COM", Gjakovë,
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunes së Gjakoves lëshon këtë:

REFERENCE

Me këtë konfirmojmë se Operatori Ekonomik NSHT "VICTORY Com", Gjakovë, ka kryer realizuar për Komunën e Gjakovës në kushtet e kontratës me numër identifikimi 532-(9-061-521, të datës 22.05.2019 punimet tok:

"Rivleratimi i Urrës së Fshajtë & Kamion" (ndriçimi, shtigjet për ecje), në vlerë 58,502.000

Bazuar në raportin e organit mbikëqyrës i cili i ka përçejllur punimet dhe atëheret e materialëve, operatori ekonomik, ka punuar me përkushtim gjatë realizimit të kontratës në datë, gjegjësisht ka kryer punë me përgjegjësi, sipas standardeve teknike ndërtimore në fuqi. Komuna e Gjakovës është e kënaqur me bashkëpunimin e mirë që kemi pasur, gjegjësisht performancën e treguar të kompanisë.

Singerlati,



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC
OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATEJA:	24.02.2020
REFERENCË:	Zyrt. 04
PËRIZAFTO:	N.Sh.T. "Viktory Com" Gjakovë, Z. Pjetër Qerimi, drejtor
CC:	Arhiva
PËRMEN/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për Arsime, Gjakovë
NGA/OD/FROM:	Z. Basmir Firokaj, drejtor i Drejtorisë për Arsime
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT	REFERENCE

Të nderuar,

Kompania N.Sh.T. "Viktory Com" nga Gjakova me drejtor Pjetër Qerimi, ka realizuar punimet sipas kontratës:
Kontrata : " Rrethime dhe rregullime të oborreve në shkollën"
Numri i prokurimit: 632-18-044-521
Datë 25.07.2018

Me këtë referencë deklarojmë se Kompania N.Sh.T. "Viktory Com" nga Gjakova, punën e ka kryer me kohë dhe në nivel profesional.
Rekomendojmë të gjithë të interesuarit në N.Sh.T. "Viktory Com" nga Gjakova është një kompani profesionale, e përgjegjshme dhe e shtikëtyeshme për bashkëpunim.

Me respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS
DREJTORIA PËR ARSIM
Pozita administrative: Sh. Nr. 1, Turrpaz, Gjakovë, Kosovë
Tel: +383 300220 234



Me kërkimin e Operatorit Ekonomik "Benita Company" Sh.p.k. & NUT.Sh. "VICTORY COM" me seli në Gjakovë, Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Gjakovës, lëshon këtë:

REFERENCË

Me këtë konfirmimë së Operatorit Ekonomik "Benita Company" Sh.p.k. & NUT.Sh. "VICTORY COM" me seli në Gjakovë, ka kryer realizimin për Komunitet e Gjakovës në kushtet e kontratës me numër identifikimi - 064, në vitin 10.08.2015 për projekt:

- "Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Felimi Agani", në vlerë 198.119,80 €

Bazuar në raportin e orgaanit mbikëqyrës i cili i ka përcjellur punimet dhe atëherë e materialëve, operatori ekonomik, ka punuar me përkatshim gjatë realizimit të projektit në fjalë, gjegjësisht ka kryer punë me përgjigjësi, sipas standardeve teknike ndërtimore në fuqi. Prandaj Komuna e Gjakovës është e kënaqur me bashkëpunimin e mirë që kemi pasur gjegjësisht përfundimin e rrugës të kontratës.

Për gjithë të Interesuarët,
me respekt,

Gjakovë,
21.02. 2018

KOMUNA E GJAKOVËS
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
Posta elektronike: info@gjakova.com, zryra@gjakova.com
8000 - 8000
www.gjakova.com



Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunë